



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 12, DATË 29.01.2020

PËR  
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SUBJEKTIT PERSON FIZIK  
RAHMAN MEKOLLARI AUTORIZUAR PËR PËRSËRITJEN E SHËRBIMIT TË  
PROGRAMIT AUDIOVIZIV TË TË TRETËVE MBËSHTETUR NË RRJET  
KABLLOR "TV KABLLOR KRISTAL", PËR REDUKTIMIN E ZONËS SË  
OFRIMIT TË SHËRBIMIT

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: Subjekti person fizik Rahman Mekollari

Objekt: Shqyrtimi i kërkesës së subjektit person fizik Rahman Mekollari, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor "Tv Kabllor Kristal", për reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit.

Baza Ligjore: Neni 19, pika 16, neni 68, germa "b" i ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 12, pika 1, "a", i rregullores "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve", miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017.

VËREN

Subjekti person fizik Rahman Mekollari, është autorizuar me shkresën nr. 533 prot., datë 11.03.2014, të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor "Tv Kabllor Kristal", me zonë ofrimi shërbimi Komunitet Hotolisht, Rushkull dhe Kosovë.

Referuar vendimmarrjeve të mëtejshme të AMA-s, zona e ofrimit të shërbimit të subjektit është Njësitë administrative Shirgjan, Qendër Librazhd, Hotolisht dhe Fierzë.

Pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë së autorizimit, AMA me vendimin nr. 100, datë 11.07.2019 rinovoi autorizimin për një afat 5 vjeçar. Afati i vlefshmërisë së autorizimit përfundon në datën 03.03.2024.

Subjekti person fizik Rahman Mekollari, me shkresën nr. 99 prot., datë 14.01.2020, të depozituar pranë AMA-s, ka kërkuar të heqë dorë nga zona e ofrimit të shërbimit *Njësitë administrative Fierzë dhe Qendër Librazhd*. Më tej, me shkresat nr. 99/1 dhe 99/2 prot., datë 16.01.2020, subjekti ka kërkuar rrëzimin e kërkesës së sipërcituar duke kërkuar përfundimisht, heqjen nga zona e ofrimit të shërbimit të Njësisë administrative Fierzë (Bashkia Belsh).

Konkretisht, subjekti parashtron se: *"...Njësia administrative Fierzë, të hiqet nga autorizimi i kabllor Kristal si dhe të hiqen detyrimet financiare për shërbimin e ofruar në këtë zonë"*.

Nga shqyrtimi i Ekstraktit Historik të depozituar rezulton se:

- Subjekti person fizik Rahman Mekollari, është regjistruar si i tillë në datën 15.04.2013; NIPT-i i subjektit është L37815601K; Objekt i veprimtarisë së këtij subjekti është: *"Shërbime të rrjetit kabllor"*; Zyra qendrore e shoqërisë është: Hotolisht Qendër, pranë postës me zonë kadastrale nr. 740870; Nr. cel: 0694613713; email: jasujosif@hotmail.com; Statusi i subjektit: Aktiv.

Ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 68 të tij, parashikon se autorizimi bëhet i pavlefshëm: *"b) i licencuari ose i autorizuari njofton me shkrim AMA-n për mbylljen e aktivitetit"* dhe rregullorja "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve", miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017, neni 12, pika 1, përcakton se aplikuesi i cili kërkon të zvogëlojë zonën e ofrimit të shërbimit për përsëritjen e programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve duhet të paraqesë pranë AMA: *"a) Kërkesë për zvogëlimin e zonës së shërbimit për përsëritjen e programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve..."*

Nga verifikimi i kryer nga Drejtoria e Mbikëqyrjes, rezulton se subjekti ka ndërprerë transmetimet kabllore në këtë zonë. Nga verifikimi i kryer nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, rezulton se subjekti person fizik Rahman Mekollari, nuk ka detyrime financiare kundrejt AMA-s.

Për sa më sipër, AMA arrin në përfundimin që kërkesa e subjektit është e drejtë dhe si e tillë duhet të pranohet,

## PËR KËTO ARSYE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në bazë të nenit 19, pika 16, nenit 68, germa "b" të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe rregullores "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve", miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017,

## V E N D O S I:



1. Pranimin e kërkesës së subjektit person fizik Rrahman Mekollari, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor "Tv Kabllor Kristal", për reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit, duke hequr nga zona aktuale "Njësinë administrative Fierzë"
2. Zona e ofrimit të shërbimit të subjektit person fizik Rahman Mekollari, ndryshon në "Njësitë administrative Shirgjan, Qendër Librazhd dhe Hotolish".
3. Subjekti me njoftimin e këtij vendimi, ka detyrimin të ndërpresë menjëherë transmetimin audioviziv në Njësinë Administrative Fierzë.
4. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare prej datës 14.01.2020.

**Kryetar:**

**Gentian**

**SALA**

**Zëvendëskryetar:**

**Sami**

**NEZAJ**

**Anëtarë:**

**Agron**

**GJEKMARKAJ**

**Gledis**

**GJIPALI**

**Suela**

**MUSTA**